

# FLUTURA ÇOÇOLI

## ËSHTË KOHË PA URTËSI

BIBLIOTEKA

8541-1  
C 74



POEZI

85H-1  
~  
C 74

FLUTURA ÇOÇOLI  
ËSHTË KOHË PA URTËSI

Poezi

Tiranë 2002

# Përbajtja

Zbehtësi	7
“Më i zgjuar se e vërteta”	8
Rreze krokodili	9
Je mal, dhe mall	10
Të malluar për gjuhën shqipe	11
U shkrinë dalldisjet	12
Rebeshesh plumbash	13
Mustaqemadhit (ose : Marosje kohe)	14
E fjetur qeshja	15
Kornizë s'e kam tradhtinë	16
Trysninë s'e huaj	17
Me revolen në brez	18
E goditi pa flakë	19
Pengje grushtesh	20
Lëkundej koha	21
Grimca mjegulle	22
Me ju, s'çel vetm	23
Ç'simbol lartësie!	24
Hija je ti	25
Bashkë me lulet unë të flisja	26
Të fle mbi petëla	27
Jetë manteli bletësh	28
Sy i blerë	29
Aty	30

Kurorë Mesdhe	31
Natyrë perlë	32
Monument pér nënët	33
S'do të shfaqej duel	34
Shumfisha bukurish	35
Të ngrish në paqe!	36
Unë puth trëndafila, ti pyllin vesò	37
Qyteti im	38
Heshtje vjetshë	39
Në dimër eja	40
Dhembja do të luajë me ty	41
Kuvli e braktisur	42
Rrjeta më s'do të thurrësh	43
Në bardhësi të venitem	44
Mos shtini, dasmorë	45
Në sy të na gjendeni	46
Plumbat, epidemi karkalecash	47
Është kohë pa urtësi	48

## Zbehtësi

Drita rrëfye se paradë të fton,  
le të belbëzojnë “mjaft më”, meskinët  
gjer në palcë kafe alaturka gëlltisin  
s’ të falin krahë, veç në vend numëro gremisin.  
Lartësi hijesh ta vrasin, ta braktisin shpresën thellas;  
dhe pse “fisnikë”;  
në emërues, nëse do t’i renditësh!  
Zbehtësi.

“Më i zgjuar se e vërteta”

Kavalieri pengjesh, muze armate,  
divizion i pasosur tregjesh – “dhunti”  
“Më i zgjuar se e vërteta”  
“gjak burrash - breznish qëmoti”  
“Napoleon Bonoparti” asht ndi.

## Rreze krokodili

A s'është vdekje gri droga?

Je dhe ti gri,  
gri jetën thurre.

I plakur lulesh, erën e argjentë shpërbëre,  
kore të plasaritura gjer në brazda akulli  
pa droje krokodili,  
veshur me mantelin e zi të sipërore absolutes  
me lumë gjunjë-gjumë lutjesh  
me botën e akordit të dhunës,  
me humbëtirën e zogut të puthjes.  
A s'është gri ndërthurja?  
Gri dhe...  
“rreze krokodili.”

Je mal dhe mall

Dhe hijen të të shoh, le të kem pranë,  
paçka se je ethe, je dhe djall,  
ke një zanë;  
përshpëritjen time ke vrarë

Ortek në mes të dimrit...

Je mall, dhe mal.

Ndeshje...

Kush është më i dobtë  
Urrejtje, dashuri; Bashkësi.

## Të malluar për gjuhën shqipe

Të mërguarit e zemrës, i përpinë së lexuari  
vargjet e Çajupit, kush t'i interpretonte më dukshëm;  
veç, kur lexuan "Deshtë dhe ujku" përrallë për fëmijë,  
me avuj-gaz-loti më shkrinë  
më mbollën fidanë hareje.

Po kaq mall - ëndje- etje, dhe për filmat shqiptarë,  
i thithën si bleta nektarin;  
gjetën, ç'gjetën, revista, libra, të marrosur,  
me vete m'i pushtuan mërgimit.

## U shkrinë dalldisjet

U shkrinë të mpirat dalldisje,  
-idhni sipërore, meskizma të plota, hark  
shigjetë për timen qënie,  
u tulat nëpër kënde e dridhnera joshje,  
kulmet-rreve, pse m'i korninzon mal?

## Rebeshesh plumbash

.... E, thika me majë ra, e u prangos dheu  
me zinxhira llave,  
rrebesch plumbash, azhur shpirti.  
E shëmbëlleu, se u mëkëmb i ballcamosur  
në përmendore xhami, Skënderbeu.

## Mustaqemadhit (ose : Marosje kohe)

Driħerimēn e fēmijēs nē sy e jetova,  
pēr njē gabim, a faj tinzar,  
burri mustaqezi rēndshēm kēmbēt pērplasi,  
me tepēr se 12 trok-kali, si i dehur, i çakērdisur;  
fēmija u shndrua nē erē, shigjetar.  
Terrori nē tru i nxinte, i dalldisur  
shikim çakērdues, i hutuar, i mjeruar.  
Jemi prindēr, o ti mustaqemadh,  
po tē ish i yti, ç'do tē ndodhте vallē?

Marrosje kohe.

## E fjetur qeshja

Rrokullisen lotët prej syrit në buzë, mjekër.  
e ujisın tokën, e mbijnë në tokë;  
si s'ka të plotfuqishëm për ne nënët të  
ç'mallemi me bijtë e mërguar përherë,  
veç e fjetur qeshja ime  
natyrë e rënduar,  
fytyrë mesnatë,  
gri agimet,  
shpirtin lëngatë.

Kornizë s'e kam tradhtinë

E zbeh momenti dashurinë,  
e zbeh akulli, tradhëtia, xhelozia.  
Më zbehu dhe mua,  
e marrosur pas saj, e kredhur, e verbër, zgjodha poezinë  
E zhgënjer, e pérndoqa zbehtësinë,  
kornizë s'e kam tradhëtinë.

## Trysninë s'e huaj

Çlirohet frysmezim nga dhembja:

Po nga urretja?

Të kisha një grimcë, dhe për këdo që  
më dogji tinëz,

se më pas më urrejnjë çiltas

le t'i përcjellë zemra.

I kam tej flakur zilinë e cmirën,  
përbuzur thashemthemnajat, përvëluar në hi,  
ndaj më mirë e vetmuar, e vecuar,  
trysninë nuk e huaj, se ma huajnë.

## Me revolen në brez

Me litarin zhgënjes fyta-fytas ia errtove  
ëndërrat qiellore,  
shikimin drithërimë ia gozhdove mbytas;  
U dallgëzua pështjellimi i tretur njësh,  
palat e frakut u vijëzuan krejt.  
Tunduesi troftat lakmimtare, i gjuante dredhas,  
“mëshirues”  
ish me hije sigurie, me brirë,  
me revolver në brez.

## E goditi pa flakë

Ia vrou imazhin e qënies grua,  
e goditi pa flakë,  
ia mpieu buzët, trurin, dhembjen,  
ish më shumë se mesnatë,  
ish më shumë se tërmet,  
ish baras me llavë, që trtetjen s'ta fal.

## Pengje grushtesh

A jeni vallë vëllezër?  
A ju mban shtëpia motra?  
Përgjigje grushtesh, pengje varri – hakmarrje!  
Ku i kemi pengjet motra?  
A s'u thahet zemra mjeronesh nëna?  
Të fton tradhtinë vrulli i çmendurisë.  
Yshte ni me natën.  
Puthem i me të.

## Lëkundej koha

Lëkundej koha...

Lëkundeshin djepet me gjak!

Lëkundej gjiri, s'kish foshnja të pinte!

Invazion koke! Invazion kohe! Gjak i mpiksur në djep!

Gërmadha prej të çmendurish!

Në fund të pusit kufoma njomishtesh!

Mot vdekjeje! Syve, shkumbëzim!

Strehat mbulonin dhembjen!

Koha s'e ndalte mallin!...

## Grimca mjegulle

Një largim – lajthitje më gërvishti i pari,  
i dyti, - tërmeti më vrau;  
sundoi loti, dhe grimca mjegulle,  
kurbeti më verboi.

Me ju, s'çel vetmi

Vetëm, e vetme ti je...  
s'mbyllët korja e plagës, veç qarkohet,  
sa pulit sytë, mjegulla, a kapërdihet?  
Jastëkët thaj, po prapë vesoj...  
dhe majë malesh sërish ngjitem...  
të humb jetët, pa jetë...  
gjithfarë lulesh, rrjedha më huajne,  
unë druaj, luaj me kaltërsinë;  
dhe hapa horizontesh në boshllëk janë panik...  
Ju përgjëroj, eni,  
me ju, s'çel vetmi.

## Ç'simbol lartësie!

Heu! I dhimbshëm skenari!  
Mësuese në Zhulat qeshë.  
I shtruar fjalëkëmbimi, - i idhët!  
    Ndaloj makina...  
Kulmvdekja nxin...  
    Sënduku i vdekjes!  
    vjeç 72  
E fundit krahështrënguar të djeshmen!  
Eh! Ç'simbol lartësie!  
    Babai im.

## Hija je ti

Po nuk e bekove, tē lēndon qielli...  
Dielli tē kērrus, po s'i ktheve krahēt.  
Tē kēput Marsi, po s'i lidhe plagēt,  
tē flakadon vullkani po indale rrymēn.  
Po i fale hijen, Jupiteri tē shtellung,  
hija je ti.

## Bashkë me lulet unë të flisja

Me flatra të ngjisja, mëngjesesh t'ju nuhasja  
tërë shpirtin tuj,  
t'ju afshoja avujt – nektar, në krahëror t'ju mbështillja;  
bashkë me zogj unë të përulem,  
bashkë me zgjimin të përkundem  
në lëndina plot me'lot.  
Dhe ky fati im i mbrapsht,  
krahët janë djegur, hiri s'fundos.  
Bashkë me lulet unë të flisja,  
bashkë me dëborën të humbisnja,  
bashkë me detin të dallgëzoj,  
bashkë me ëndërra të vallëzoj,  
bashkë me hënën të shëtisja,  
nëpër pyje plot me zogj.

Të fle mbi petëla

Më çmendën lulet sot,  
më lakuan, më çliruan fare,  
të zbres, të zbres, të çlodhem,  
të rroj, të fle mbi petale.

## Jetë manteli bletësh

Mes degësh të lulëzuara kumbullash – copëza kaltërsish,  
mendjen ma stepën.

nuhatje bukurish, jetë manteli bletësh;  
mijra ruzuj të veckël, arkitekture mozaikësh pistili –  
mahni,  
me dhjetra kurora nusesh, më luhatën, peisazh bardhësie  
në avli.

Dimër dhe pranverë njëherësh, a s'është skaj ky?  
Ja, dhe qukapiku fluks ngjyrash, sytë ëmbël m'i verbon,  
çukit degësh mani, prej meje u druajt, tejshëtit lartësish.

## Sy i blerë

Thellë dallgësh të pashë në Otranto të lashë,  
o zoti im a më dëgjon?

Zemra më therr, vesë më gjëmëton,  
një shpatë ma dhe, shtatin të përgjysmoj.

Në terr pse më kalle, o, ti sy i blerë?

Ma nxive veçimin, shosh më fal,  
trysninë e ngrirë s'e shkrijnë as të nxehtrash  
afshe valë.

## Aty

Aty sundon e egra dhe ritmi lotues,  
aty troket dimri dhe pranvera,  
aty derdhet erozioni dhe natësia e dhembjes  
aty qetësohet i mbështjelli dert,  
aty skicoj timen tretësirë,  
me sytë e diellit,  
me sytë e mjellmës.

## Kurorë Mesdhe

Pse qielli sot më duket më shumë blu?  
Mos vallë dëbora i jep synë e stinës së re?  
Pse malet tashmë më ngjajnë të ngrohtë, të afërt?  
Ndoshta jetoj, vallëzoj mes syresh e kaltër?  
Sodis pemët në lulëzim, më shumë se hijeshi,  
veç qielli, kodrat dhe malet i japin qytetit tim  
kurorën Mesdhe.

## Natyrë ‘perlë’

Këta sokakë të thellë, të thella dhe ëndrrat,  
e thellë dhe qënia...

Veç kjo natyrë “perlë” të çliron trysnitë false,  
ta ndjesh e ta kundrosh, kur je në mugëtirë,  
veç ta blesh, dhe kryelartë të ndihesh, si princeshë e  
virgjër.

## Monument për nënët

Sa shkrij në buzë të kuqin tënd trëndafil,  
je dhe ti trëndafil në buzët e mi,  
u shtrova një lule blu karafilave të kuq  
të shihnjë e të kujtonja përherë sytë e tu.  
Largësi, e shpikur për mall për të ikurit,  
dhembje, lot, èndrra –  
sy i pagjumë-  
monument për nënët.

## S'do tē shfaqej duel

Vijédrejtë tē ish dheu, jo glob,  
do tē thyheshin vetëtima dallgësh, s'do tē kish mort,  
s'do tē lëkundej tërmeti-deti, s'do tē fluturonin alienë,  
s'do tē lartësohej sterrë-mali, do tē shihnim tre diej,  
s'do tē frynte erë dimri resh, veç qielli,  
s'do tē mpreheshin harqe shpatash, s'do tē shfaqej duel.

## Shumfisha bukurish

Me një vresht akaciesh përballem, një bisk lulëzimi këpus,  
e ato më këndojnë me pak rruaza vargjesh.  
Burretoja përkundruall, ylbere dallge, rudha fraku  
kadife qiellore rezatona,  
pelerinë argjëndi Nemërçka, rezonancë kristali  
dimër, verë,  
ndërsa kodrat e blerimi përfund, shumëfisha bukurish  
parade.  
Brilante dhe mbrëmjesh: dritat prej ajri tundohen lehtë.  
më rrokullis gjumin kjo natyrë perlë e vjelë.

Të ngrish në paqe!

Të ngrish në paqe, s'është mahni?  
Të rrokullisesh; të bësh ligje?  
Të çmallesh me terrin? Të ngrohesh me akullin?  
Të lindësh shtirje duartrokitjesh?  
Të priresh me thithëse loti?  
Të të zgjojnë goditje lajthitjesh?  
Jo! S'është shaka!  
Po zemërshkëmb nëne.

Unë puth trëndafila, ti pyllin vesò

Mali bëhet akull, qielli re dielli,  
më afro buzën tënde, sa të hyjë prilli.  
Flatra vë mbi krye, të vallëzosh mbi lule,  
unë puth trëndafila, ti pyllin me shkurre.  
Tradhëtinë e athët, s'e veçoj as dimrit,  
në lëndina gjembat digjen, shndrohen prej hirit.  
Pylli ma vesò, luaj me kitare,  
dritaresh nate shpalos pranverën e vrarë.

## Qyteti im

Blerimi dhe kodrat përkundin mbi duar malet,  
lartësi pasqyre e kurorës së qytetit tim,  
kështjellën, titanik lashtësie, në sy fshehin,  
nostalgji mbretërore shpatash lakmitare,  
me djepet në gjitë.

## Heshtje vjetshë

Te guvë e piratëve u çarmatosën gungaçët,  
prisnin sjellësin e qelliit,  
shtegëtimi pa vulë s'i kishte bekuar,  
i rrihte breshëri në ullishtë...  
Në planet tjetër shtreson mjegullnaja,  
gjumi i ozonit zotëron vrullshëm,  
zogu i ujit vritet në heshtje vjeshte...

## Në dimër eja

Potpuri cicërimash, në maj kanë ëmbëlsi,  
përkëdhelin natyrën zogjtë.  
Mos më thirr mes jargavanësh, kanarinë,  
në bardhësi acari eja, kur unë kam ftohtë.

Dhimbja do t  luaj  me ty

Do t  luash me vorbull n?  
Dhimbja do t  luaj  me ty,  
kalt rsira shndrohet n  er ;  
dhimbja s'b het harres ,  
jan  indet q  luajn ,  
 sht  zemra q  s'b lihet.

## Kuvli e braktisur

Ma rikthyhet magjinë e kristaltë,  
kuvlia ime u blerua,  
ëndshëm pushtonin notat cicërimash,  
pa zogj të vegjël ndër vite...  
Në dimër heshtje...

Kuvli e braktisur...

## Rrjeta më s'do të thurrësh

Ti që blen zemra, dejtë do të të digjen,  
rrjeta më s'do të thurresh,  
veç me sorra do të lëngosh  
sytë do të të sodisin hijet  
natyra çengela do të të zgjasë  
për shtat ke humbëtirën  
dhe për masë pikëpyetjet.

## Në bardhësi të venitem

Një sy shigjetë rrezaton dielli,  
retë shijore s'e çlirojnë,  
mirëpresim magjinë dëborë të bjerë,  
në bardhësi të venitemi:  
‘Të rrëkëllej shampanjën lakmitare,  
pak etjen time të nxeh,  
sokakët vagabondë – zhgënjam të sodis,  
zhduket në zbehtësi lulevjeshta,  
të kacavirem në qiparisa  
pabesitë të kundroj nga foletë.’

## Mos shtini, dasmorë

Hej, mos shtini dasmorë, se mbillna vdekjen!...

Këmisha e forcës s'ndigjoi.

Si flokë dëbore e zënë vallzonin plumbat. . .

U tërbuan kreshtat...

...Dhe bregu i diellit heshti...

Ku je klithmash s'rreshtën...

U nxinë gotat nga raki morti,

Velloja u shndrrua në qefin për arkivol.

**Në sy të na gjendeni**

M...më...ma...

Dhe e vockël gojëz thith nektarin e bardhë, të filtër.

Ma...mami

Dhe shkrepëtimë loti, kur s'e ndjen  
për një çast.

Sa pushtohet në duart e nënës i mitur,  
s'lajthit shkëputje;  
në sy të na gjendeni, kur të  
puthim dhe, dhe... në skaj.

## Plumbat, epidemi karkalecash

Kundroj Gëten në Alpe, Romë, Venecia,  
në karnavale imazhet kërkoj...  
Ty, e largët, e kredhur, do të të shoh?  
Do të të prek?

Matildë!

Ndërkohë Shopenin ndjek...  
Bethoven, sonatë 13...  
Ç'është kjo vorbull që vret?  
Shoqe është muzika, dhe frika...  
Ç'skenar i dhimbshëm!  
Ç'mbetet veç zemrës?  
Të trokasë... të trokasë.  
Epidemi karkalecash – plumbat në qiell.  
Të vij? Të flatroj si shpend?  
Fsheh dhe dy vogëlushë nën strehë.  
Vetëm mes plumbash t'i le?

## Është kohë pa urtësi

Lotët pse mi ende, të më mjergullojnë?  
Hijen ma le të çmallem.  
Thinjat e tua mi mbolle në zemër,  
Buzëqeshjen e prerë, sa fillon një ëndërr...  
Sytë mi dhe të reflektoj paksa diku,  
Veç shigjeta nuk pate, si i përshkoj unë.  
Ankthin mal, se s'pata strehë,  
Ma thellove mprehtas, mos ndihem lehtë.  
Urtësinë ma skalite, është kohë pa urtësi,  
Më pushton në ëndërr, të flemë nënë e bi.j